



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
DREJTORIA PLANIFIKIMIT KONTROLLIT ZHVILLIMIT TERRITORIT

Nr. 4416 Prot

Laç, më 14/12 / 2016

Lënda: *Kërkesë*
“Për marrjen e Aktit të Konformitetit për PPV-në e Bashkisë Kurbin”

Drejtuar: *Znj. Adelina Greca, Drejtori i Agjencisë së Planifikimit të Territorit*
Rruga Muhamet Gjollesha

Tiranë

E nderuar Znj. Greca,

Bazuar në ligjin 139/2015 datë 17. 12. 2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 107/2014 datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, VKM nr. 671 datë 29.07.2016 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, Marrëveshjen trepalëshe ndërmjet Ministrisë Zhvillimit Urban, Bashkisë Kurbin dhe konsulentit UTS-01, shkresës së ardhur nga Ministria e Zhvillimit Urban me nr. 6406, datë 01. 12. 2016 “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor”, kërkojmë na ana juaj:

Pas krijimit të dosjes me dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor me nr. 4310 Prot, datë 09.12.2016 kërkojmë marrjen e Aktit të Konformitetit mbi Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Kurbin që të vijohet me shqyrtimin e Planit në Këshillin Bashkiak.

Njoftojmë që i jemi drejtuar Ministrisë së Shtetit për Çështjet Vendore dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban përse i përket përcaktimit të kufinjëve administrativ territorial për Njësitë e Qeverisjes Vendore, pasi dhe nga takimet trepalëshe të zhvilluara mes Bashkisë Kurbin, AKPT dhe Konsulentit UTS-01, jemi të bindur që kufiri i vënë në dispozicion nga ana juaj konsulentit UTS-01, nuk është ai që Bashkia Kurbin pretendon të jetë.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!

Kryetari i Bashkisë

Artur BARDHI

